

KËRKESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT
(SHËRBIMET E KONSULTIMIT)
(Ri-shpallje)

VENDI - Kosovë

EMRI I PROJEKTIT – Projekti i Konkurrencës dhe Gatishmërisë për Eksport në Kosovë

Nr. i Kredisë. 6035XK

Nr. ID së Projektit 152881

TITULLI I DETYRËS: VLERËSIM TË TIK, ANALIZA E PROCESIT BIZNESOR DHE PËRGATITJA E

SPECIFIKIMEVE TEKNIKE PËR SISTEMIN E INSPEKTIMEVE ELEKTRONIK DHE SISTEMIN E

INTEROPERABILITETIT TË INSPEKTIMEVE

Nr. i Referencës: 1.3.1

Date:20/07/2020

1. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE INFORMATA PËR SITUATËN AKTUALE

Projekti synon të forcojë kapacitetin e institucioneve publike të përzgjedhura në Kosovë që kontribuojnë në avancimin e eksporteve dhe konkurrueshmërinë e sektorit privat. Projekti synon të përmirësojë mjedisin e biznesit dhe gatishmërinë për eksport të firmave duke përmirësuar infrastrukturën kombëtare të cilësisë, duke mbështetur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM) me potencial eksporti, dhe duke reformuar sistemin e inspektimeve të bizneseve. Rritja e produktivitetit, përmirësimi i cilësisë së produktit dhe ulja e kostos për inspektimet e biznesit janë hapa jetik për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe gatishmërisë për eksport të firmave në Kosovë.

Nën-komponenti 1.3 i projektit mbështet zvogëlimin e barrës administrative për bizneset përmes reformimit të sistemit të inspektimeve të biznesit. Një sistem inspektimi i dizajnuar mirë mund të krijojë zgjidhje “me përfitime të dyanshme” (win-win) për të gjitha palët e interesuara. Nëse kërkesat themelore ligjore janë të targetuara dhe të dizajnuara mirë, zbatimi i tyre krijon përfitime, zvogëlon kostot dhe nxit llogaridhënien dhe procesin e duhur, duke rritur kësisoj mirëqenien sociale. Në të kundërtën, sistemi i inspektimit është një barrë e tepërt për bizneset dhe krijon mundësi për korrupsion dhe abuzim.

Qeveria e Kosovës tashmë ka ndërmarrë masa për të reformuar inspektimet e biznesit. Përmes vendimit nr. 05/138, më 22 mars 2017, qeveria themeloi një grup punues të udhëhequr nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me mbikëqyrje nga Zyra e Kryeministrit. Grupi punues analizoi dhe përgatiti rekomandimet dhe koncept dokumentin për Ligjin e ri për Inspektime, i cili pritet t'i dërgohet Kuvendit. Grupi punues gjithashtu monitoron hartimin e ligjit të ri për inspektime dhe rishikimet e rregulloreve.

Njëkohësisht, projekti është duke mbështetur prezantimin e një sistemi të përbashkët të informacionit për inspektimin – Inspektimet Elektronike, që është një zgjidhje e TIK në shkallë vendi për menaxhimin e inspektimeve. Sipas planit të projektit, kujdesi i duhur ndaj TIK si dhe vlerësimi për inspektimet elektronike dhe për interoperabilitetin e të dhënave të lidhura me inspektimin, do të fillohet sapo të fillojë projekti. Kjo punë fillestare do të sigurojë bazën për fazën e radhës, që është prokurimi i shitësve të programeve softuerike për zbatimin e sistemit të inspektimeve elektronike, interoperabilitetin e të dhënave të inspektimit dhe pajisjet harduerike, në pritje të miratimit të Ligjit të ri për inspektimet.

Inspektimet elektronik (e-inspektimet) do të mundësojnë një platformë të integruar të inspektimit digjital për planifikim dhe koordinim të inspektimeve në Kosovë, menaxhim të vizitave inspektuese, përdorim të listave të kontrollit të inspektimit, menaxhim të dosjeve të lëndëve dhe dokumenteve, raportim të brendshëm dhe të jashtëm, analitikë të të dhënave dhe menaxhim të rrezikut. Sistemi i interoperabilitetit të të dhënave të inspektimit do të mundësojë shkëmbimin e të dhënave mes autoriteteve dhe organizatave të ndryshme, i cili bashkëpunim është i domosdoshëm për inspektime të bazuara në rreziqe, profilizim më të mirë të rrezikut të biznesit dhe zvogëlim të informalitetit. Projekti do t’u sigurojë inspektorëve edhe pajisje për analizë në terren, marrje të mostrave dhe mbledhje të dëshmive, si dhe ngritje të kapaciteteve dhe mbështetje për të siguruar qëndrueshmërinë e organizimit të sistemit të ri të inspektimit.

2. FUSHËVEPRIMI I SHËRBIMEVE, DETYRAT DHE REZULTATET E ARRITSHME

Objekti i këtyre TeR është të angazhoj një firmë konsulente për kujdesin e duhur dhe vlerësimin e TIK-ut, dizajnimin e nivelit të lartë, si dhe për kërkesat funksionale dhe teknike për zbatimin e sistemit të inspektimit elektronik dhe sistemit të interoperabilitetit të inspektimit. Në veçanti, firma konsulente do të sigurojë shërbimet e mëposhtme:

- (i) **Kujdesi i duhur dhe vlerësimi i kapaciteteve të TIK-ut të inspektorateve dhe e-Qeverisë për zbatimin e sistemit të Inspektimeve Elektronike dhe Sistemin e Interoperabilitetit të Inspektimeve.** Kujdesi i duhur dhe vlerësimi do të ngërthejnë aspektet e politikave, ato strategjike, organizative, procedurale dhe teknike, dhe do të mbulojë kapacitetet vertikale dhe regjistrat përkatës në sektorë, si dhe parakushtet horizontale të e-Qeverisë për sistemin e Inspektimeve elektronike dhe atë të interoperabilitetit.
- (ii) **Zhvillimi i kërkesave të nivelit të lartë të dizajnit, atyre teknike dhe funksionale për sistemin inspektimeve elektronike për Kosovën,** duke zbatuar praktikat e mira globale në këtë fushë në mjedisin lokal dhe opsionin e zgjedhur të mundshëm. Rezultati i kësaj pune do të jetë një analizë gjithëpërfshirëse e procesit të biznesit, dokumentacionit teknik dhe të dhënat e tjera teknike për prokurimin e shitësit për zbatimin e Inspektimeve elektronike (e-inspektimeve).

- (iii) **Zhvillimi i kërkesave të nivelit të lartë të dizajnit, atyre teknike dhe funksionale për zbatimin e sistemit të interoperabilitetit të inspektimit.** Si pjesë e këtij aktiviteti, firma konsulente do të zhvillojë specifikime teknike për përmirësimin e infrastrukturës së interoperabilitetit të e-Qeverisë dhe segmenteve të tjera horizontale për zbatim të suksesshëm të sistemit të interoperabilitetit të inspektimeve. Rezultati është dokumentacioni teknik gjithëpërfshirës dhe inpute të tjera teknike për procesin e prokurimit.

Puna e konsulencës do të organizohet sipas dy fazave kryesore:

- (i) **Faza e parë do të fillojë pas nënshkrimit të kontratës, dhe do të përfshijë detyrat e kujdesit të duhur dhe të vlerësimit të TIK-ut.** Këto detyra nuk varen nga miratimi i një kornize të re ligjore për inspektime në Kosovë, prandaj ato mund të kryhen paralelisht me miratimin e kornizës ligjore.
- (ii) **Faza e dytë do të fillojë pas miratimit të Ligjit të ri për inspektime dhe emërimin e inspektorit të përgjithshëm.** Faza e dytë është faza e dizajnit të sistemit të inspektimit elektronik dhe atij të interoperabilitetit, duke përfshirë specifikimet teknike për pajisjet kompjuterike harduerike. Sipas Ligjit të ri për inspektime, Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm është përgjegjëse dhe duhet të koordinojë dizajnin e e-Inspektimeve. Faza e dytë mund të fillojë pasi të miratohet Ligji i ri për inspektimin, dhe pasi të emërohet inspektori i përgjithshëm.

Faza e dytë e kësaj detyre do të fillojë pasi të jenë krijuar këto parakushte. Përmeshja e këtyre parakushteve nuk është nën kontrollin e Klientit dhe as nuk mund të ndikohet nga klienti.

Firma e Konsulencës pritet të realizoj vlerësimin e kujdesit të duhur dhe TIK-ut në institucionet vijuese:

- Inspektoratin e Tregut
- Inspektoratin e Punës
- Inspektoratin e Arsimit
- Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës
- Inspektoratin e Mjedisit, Ujit, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit
- Inspektoratin e Trashëgimisë Kulturore
- Min. të Infrastrukturës / Departament të Inspektoratit
- Inspektoratin Shëndetësor
- Inspektoratin farmaceutik
- Inspektoratin e Energjisë
- Drejtorinë e Inspektimit Qendror të Pylltarisë dhe Gjuetisë - Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK)
- Inspektoratin e Kontrollit Teknik - Agjencia e Zhvillimit Bujqësor
- Drejtorinë Qendrore të Inspektimit për Pyjet dhe Gjuetinë - Drejtoria e Inspektoratit
- Departamentin e Sigurisë Publike në MPB
- Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore
- Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave
- Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI).

Nëse është e nevojshme, lista aktuale mund të zgjerohet për të përfshirë organe të tjera të inspektimit. Firma e konsulencës do të jetë përgjegjëse për të rishikuar listën dhe përfshirë të gjitha palët përkatëse të interesit si pjesë e përgatitjes së planit teknik të menaxhimit të projektit për këtë detyrë.

Meqenëse projekti tashmë është lansuar, ka filluar mbledhja dhe vlerësimi fillestar i të dhënave dhe rezultatet do të ndahen me firmën e konsulencës. Firma e konculencës do të rishikojë informacionin e mbledhur, si dhe do të siguroj çfarëdo informacioni tjetër të nevojshëm për kujdes të duhur dhe vlerësim teknik gjithëpërfshirës.

E gjithë korrespondenca gjatë vlerësimit dhe analizës së institucioneve pjesëmarrëse do të bëhet në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

Elaborimi i detyrave dhe rezultateve të arritshme për këtë detyrë është dhënë më poshtë.

Faza I - Kujdesi i duhur dhe vlerësimi i TI-së

Detyra 1.1: Përgatitja e planit teknik të menaxhimit të projektit/detyrës,duke identifikuar një listë të palëve të interesit dhe të gjitha aktivitetet e detajuara për kujdesin e duhur dhe vlerësimin e TIK-ut si dhe hartimin e sistemit të e-inspektimeve dhe sistemit të interoperabilitetit të inspektimit. Plani teknik i menaxhimit të projektit do të ndajë aktivitetet në dy faza dhe do të marrë përsipër fillimin e fazës së dytë pas miratimit të Ligjit për Inspektimet dhe emërimin e inspektorit të përgjithshëm. Më poshtë janë rezultatet e arritshme të Detyrës 1.1:

- **Rezultati i arritshëm 1.1.1: Plani teknik i menaxhimit të funksioneve të konsultimit/projektit,** përfshirë një listë të palëve të interesit, planin e zbatimit me afatin kohor; dhe një plan për menaxhimin e rrezikut.

Detyra 1.2: Vlerësimi i kapaciteteve teknike të inspektorateve dhe e-qeverisjes, për zbatimin e sistemit të e-inspektimeve dhe sistemit të interoperabilitetit të inspektimit. Rezultati i kësaj detyre do të jetë vlerësimi gjithëpërfshirës, analiza e fizibilitetit dhe nota/koncepti teknik për zbatimin e sistemit të e-inspektimeve dhe sistemit të interoperabilitetit të inspektimit për Kosovën. Raporti për vlerësimin dhe analizën e gjendjes aktuale duhet të përmbajë një përshkrim të shkurtër të strukturës organizative dhe proceseve për secilin inspektorat, si dhe përshkrime të detajuara të sistemeve ekzistuese të informacionit (pajisjet harduerike dhe softuerike, bazat e të dhënave, infrastruktura e rrjetit, infrastruktura e sigurisë, burimet

njerëzore, etj.). Vlerësimi gjithashtu do të përfshijë ndërveprimin e qeverisjes elektronike dhe shërbimet e tjera horizontale (siç është PKI), të cilat janë gurthemeli për zbatimin e sistemit të inspektimit elektronik dhe interoperabilitetit të inspektimit. Vlerësimi i e-qeverisjes do të jetë me rëndësi të veçantë për hartimin e një koncepti dhe qasje për zbatimin e sistemit të interoperabilitetit të inspektimit. Në mënyrë ideale, një sistem i tillë bazohet në kornizën dhe infrastrukturën e interoperabilitetit të e-qeverisjes, si dhe në shërbimet e tjera horizontale të e-qeverisjes. Më poshtë janë rezultatet e arritshme të detyrës 1.2:

- **Rezultati i arritshëm 1.2.1: Vlerësimi i kapaciteteve teknike për zbatimin e sistemit të e-inspektimit dhe interoperabilitetit të inspektimit, përfshirë:**
 - (i) Përshkrimin e strukturës organizative të institucioneve relevante për projektin, në veçanti organizimi i inspektorateve, numri dhe vendndodhja e zyrave të degëve, numri i inspektorëve, pajisjet kompjuterike dhe qasja në internet e klientit, njohuritë kompjuterike të inspektorëve, stafi i TI-së, nevojat për trajnim, dhe informacione të tjera;
 - (ii) Analizën e infrastrukturës së e-qeverisjes, përfshirë politikën, kornizën ligjore dhe procedurale të e-qeverisjes, strategjinë dhe planin e veprimit të e-qeverisjes, statusin e përbërësve horizontalë të qeverisjes elektronike (e-ID dhe Infrastruktura e Çelësit Publik (*Public Key Infrastructure*), interoperabilitetin, pagesën elektronike, qendrën e të dhënave/hostimi në cloud, dhe të tjera), stafin e TI-së dhe burimet e tjera, statusin e projekteve të vazhdueshme dhe të planifikuara;
 - (iii) Analiza e infrastrukturës së rrjetit qeveritar, qasja në internet ofruar inspektorëve si dhe mbulimi dhe kostot e brezit të gjerë mobil;
 - (iv) Analizat e aplikacioneve ekzistuese softuerike në përdorim nga inspektoratet, si dhe bazat e të dhënave dhe bazat e të dhënave dhe sistemet e jashtme të informacionit në të cilat qasen inspektorët për qëllime të inspektimit (të tilla si regjistri i tatimpaguesve, regjistri i punonjësve, regjistri ose rregulloret, regjistrat e licencave dhe lejeve, statistikat shtetërore, sistemet e njoftimit të shpejtë, sistemi i informacionit doganor, të dhënat e sektorit privat dhe sistemet e tjera);

Detyra 1.3: Hartëzimi AS-IS i proceseve të inspektimit, regjistrat dhe kërkesave të të dhënave, duke identifikuar aktivitetet dhe proceset e inspektimit, inputet dhe outputet, dhe dokumentet, kohëzgjatja, baza ligjore - listën e rregulloreve, për çdo inspektorat në Kosovë. Në veçanti, firma për konsulencë duhet të mbledh shembuj të dokumenteve të inspektimit, raporte statistikore dhe të identifikojë të gjitha të dhënat që inspektoratet po mbledhin, shkëmbejnë dhe analizojnë. Përshkrimi i aktiviteteve të inspektimit AS-IS duhet të përfshijë planifikimin e inspektimit vjetor dhe operacional, kryerjen e inspektimeve, marrjen e mostrave laboratorike, menaxhimin e regjistrave të zyrave, dhe procedurat e arkivimit, menaxhimin e ankesave, dhe procedurat e tjera. Firma konsulente pritet të përdorë standardin e modelit dhe shënimeve të procesit të biznesit (BPMN), për të prodhuar një model gjithëpërfshirës për analizë dhe një bazë për ri-dizajnimin në fazën e ardhshme të funksionit. Më poshtë janë rezultatet e arritshme të detyrës 1.3:

- **Rezultatet e arritshme 1.3.1: Hartëzimi dhe analizimi i procesit të inspektimit AS-IS, përfshirë:**
 - (i) Hartat e procesit AS-IS BPMN të të gjitha aktiviteteve të inspektimit të organizuara sipas zinxhirit të vlerës së inspektimit, nga planifikimi i inspektimit dhe menaxhimi i ankesave, gjatë kryerjes së inspektimeve, menaxhimit të zbatimit dhe procedurës së apelit, deri te raportimi statistikor, monitorimi dhe analiza;
 - (ii) Analiza e proceseve AS-IS me rekomandime për përmirësim të bazuara në praktika të mira në menaxhimin dhe kryerjen e inspektimeve me përdorimin e teknologjisë. Analiza duhet të marrë parasysh kërkesat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe rregulloreve për menaxhimin dhe arkivimin e regjistrave të zyrave;
 - (iii) Identifikimi i burimeve të informacioneve dhe të dhënave të brendshme dhe të jashtme në përdorim nga inspektoratet, dhe ndërlidhja e të dhënave dhe dokumenteve me detyrat e procesit; Në veçanti, përmes platformës ASHI Interoperabilate Gateway (GG) do të analizohet ndërveprimi i sistemeve të jashtme të informacionit, si ai i Administratës Tatimore (ATK), Regjistrat të biznesit (ARBK), doganave, regjistrat civil dhe të tjerat.
 - (iv) Repositori me shembuj të dokumenteve të inspektimit, shabllone të dokumenteve, raporte statistikore dhe raporte të tjera të inspektimit.

Faza II – Dizajni i nivelit të lartë dhe zhvillimi i specifikimeve funksionale dhe teknike

Detyra 2.1: Zhvillimi i notës dhe konceptit të fizibilitetit për zbatimin e sistemit të e-inspektimeve dhe interoperabilitetit të inspektimit. Analiza e fizibilitetit dhe shënimi teknik do të paraqesin një qasje të përgjithshme për zbatimin e këtyre zgjidhjeve të TI-së, përfshirë inputet teknike për planin e prokurimit, afatin kohor të zbatimit, vlerësimin e buxhetit të nivelit të lartë, rreziqet dhe veprimet lehtësuese, dhe elemente të tjera të konceptit të projektit. Më poshtë janë rezultatet e arritshme të detyrës 2.1:

- **Rezultatet e arritshme 2.1.1: Shënim i fizibilitetit dhe koncepti i sistemit të e-inspektimit dhe interoperabilitetit të inspektimit, përfshirë:**
 - (i) Përzgjedhja e zbatimit të mundshëm të sistemit të e-inspektimeve dhe sistemit të interoperabilitetit të inspektimeve për Kosovën, koncepti me fushëveprim, qasja e zbatimit, afati kohor me pikat kryesore, vlerësimi i nivelit të lartë të buxhetit, rreziqet, dhe inputet për planin e prokurimit, nëse inputet e tilla do të ishin të nevojshme në këtë fazë të detyrës);
 - (ii) Prezantimi në PowerPoint i sistemit të e-inspektimit dhe sistemit të interoperabilitetit të inspektimit, dhe një dokument dy faqe që ofron një pasqyrë të përgjithshme për menaxhimin;
 - (iii) Punëtori për të paraqitur konceptin e sistemit të inspektimit elektronik dhe sistemit të interoperabilitetit të inspektimit për Kosovën për të gjithë akterët kyç.

Detyra 2.2: Dizajnimi i proceseve të inspektimit TO-BE, duke i krijuar hartat e procesit të BPMN-së bazuar në kornizën e re ligjore të inspektimit dhe bazuar në rekomandimet e marra. Dizajni TO-BE duhet të përfshijë përdorimin e mjeteve dhe teknikave moderne të inspektimit siç janë modelet e rrezikut, sistemi i menaxhimit të ankesave, modelet e menaxhimit të zbatimit,

listat e kontrollit të inspektimit, vetëvlerësimi dhe mjeteve të tjera. Firma konsulente do të bashkëpunojë ngushtë me konsulentët e angazhuar në zhvillimin e këtyre mjeteve dhe teknikave të inspektimit në mënyrë që hartimi i proceseve të përfshijë qasjen e re të inspektimit të bazuar në rrezik. Firma konsulente gjithashtu do të zhvillojë modelin e fushave dhe funksioneve të inspektimit, i cili do të mundësojë bashkëpunimin e inspektorateve të ndryshme, së bashku me një dallim të qartë të juridiksioneve. Firma konsulente do të zhvillojë një model të standardizuar të raportit/procesverbalit të inspektimit, vendimit të inspektimit dhe dokumenteve të tjera të inspektimit në të gjithë inspektoratet në Kosovë. Dizajni TO-BE do të përfshijë gjithashtu identifikimin e të dhënave të jashtme, regjistrat dhe sistemet e informacionit të nevojshme për planifikimin dhe kryerjen e inspektimeve. Më poshtë janë rezultatet e arritura të Detyrës 2.2:

- **Rezultati i arritshëm 2.2.1: Dizajnimi i proceseve të inspektimit TO-BE, dokumenteve të inspektimit, dhe të dhënave për inspektimet e bazuara në rrezik, përfshirë:**
 - (i) Diagramet e procesit BPMN-së të TO-BE të standardizuara në të gjithë inspektoratet në Kosovë, me identifikimin e inputeve dhe outputeve, regjistrave dhe dokumenteve;
 - (ii) Modelet e standardizuara të procesverbalit të inspektimit, vendimit të inspektimit dhe dokumenteve të tjera të krijuara gjatë procesit të inspektimit; dhe
 - (iii) Matricat e standardizuara të raportimit statistikor të inspektimit bazuar në TKP-të e ri.

Detyra 2.3: Dizajni i nivelit të lartë, dhe specifikimet funksionale dhe teknike të sistemit të e-inspektimeve, bazuar në vlerësimin, konceptin e dakorduar dhe praktikat më të mira. Gjatë krijimit të specifikimit teknik, është e detyrueshme të merret parasysh mundësia e përdorimit të infrastrukturës tashmë ekzistuese të sistemit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) në Ministrinë e Administratës Publike të Republikës së Kosovës. Disa nga funksionalitetet që dizajnët dhe specifikimet teknike do të shtjellojnë janë dhënë më poshtë:

a) Mbështetja për planifikimin e inspektimeve, për kryerjen e inspektimeve, dhe për inspektimet pasuese:

Kjo përfshin automatizim për aspekte të ndryshme të procesit të inspektimit dhe menaxhimit të përgjithshëm të inspektimeve, siç janë:

- Shkëmbimi i të dhënave për bizneset dhe ndërmarrjet për të formuar një regjistër të subjekteve dhe objekteve të inspektimit
- Menaxhimi i rasteve dhe dokumenteve
- Planifikimi i inspektimeve të bazuara në rrezik
- Njoftimi për inspektime
- Planifikimi i orarit të inspektimeve
- Menaxhimi i ankesave
- Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe materiale
- Përdorimi i listave të kontrollit të inspektimeve
- Raportimi i inspektimeve
- Menaxhimi i zbatimit
- Inspektimeve pasuese
- Komunikimi me sektorin privat (p.sh., përmes SMS, e-mail, posta në masë për grupe specifike, njoftimi mbi shkelje, etj.)
- Llogaritja e vlerësimit të rrezikut të bizneseve dhe institucioneve, bazuar në modelet e rrezikut të zhvilluar për domenet dhe fushat e inspektimit

b) Qasja e bazuar në profil

Sistemi lejon përdorimin e roleve/profileve të përdoruesit me nivele dhe lloje të ndryshme të qasjes varësisht nga përkatësia e organizatës dhe roli i përdoruesit (p.sh., administrues, super-përdorues i inspektoratit, stafi i inspektoratit, bizneset e sektorit privat).

c) Mjeti (motori) i raportimit

Sistemi mbështetë dizajnin dhe krijimin e raporteve të ndryshme siç janë raportet e progresit, raportet e menaxhimit, statistikat, në nivele të ndryshme, përfshirë nivelin e inspektorëve, departamenteve, inspektorateve dhe një sistemi të tërë inspektimi. Konsulenti identifikon listën e raporteve standarde sipas Procedurave Standarde të Operimit. Sistemi gjithashtu duhet të lejojë përdoruesit fundorë të gjenerojnë raporte të personalizuar sipas nevojës.

d) Baza e të dhënave e bizneseve dhe institucioneve që i nënshtrohen inspektimit – regjistri i subjekteve dhe objekteve të inspektimit

Ky komponent përfshin bazën e të dhënave të ndërmarrjeve dhe institucioneve që i nënshtrohen inspektimit në Kosovë. Kjo do të jetë bazë qendrore e të dhënave e qasshme nga të gjithë inspektoratet. Baza e të dhënave duhet të përfshijë informata profili për secilën ndërmarrje dhe institucion, siç janë:

- Emri i ndërmarrjes, numri identifikues
- Lokacioni i objekteve
- Informatat kontaktuese për secilin objekt
- Treguesit për vlerësimin e rrezikut dhe informata të tjera.

e) Menaxhimi dhe arkivimi i dokumenteve

Sistemi do të ketë funksionin e qëndrueshëm të menaxhimit dhe arkivimit të dokumenteve, përfshirë mbështetjen për formatet e ndryshme të dokumenteve dhe fajlleve (p.sh. PDF, JPEG, Word).

f) Siguria e informacionit

Sistemi duhet të ndjekë praktikat më të mira për qasjen, aplikim, bazën e të dhënave dhe operacionet (kopjet rezervë (backup), vazhdimësia e biznesit dhe rimëkëmbja nga fatkeqësitë).

Në vazhdim janë dhënë rezultatet e arritshme të Detyrës 2.3:

- **Rezultati i arritshëm 2.3.1: Specifikimet funksionale dhe teknike të e-inspektimit dhe inputeve tjera teknike për dokumentacionin e tenderit, përfshirë:**

- (i) Deklarata e punës, me dizajn të nivelit të lartë, fushëveprim, arkitekturë konceptuale, qasje të zbatimit, pikat kryesore, detyrat, rezultatet e arritshme, rreziqet, supozimet dhe kufizimet;
- (ii) Zbërthimi i funksionaliteteve me diagramet e rasteve të përdorimit, përshkrimi i funksionaliteteve të detyrueshme dhe opsionale dhe karakteristikave të tjera;
- (iii) Kërkesat jofunksionale dhe teknike, përfshirë modelin e shpërndarjes, interoperabilitetin dhe kërkesat e tjera;
- (iv) Plani i zbatimit dhe inputet e tjera teknike për dokumentacionin e tenderit sipas modelit që do të prezantohet nga klienti;
- (v) Hulumtimi i tregut për të identifikuar kompanitë vendore dhe ndërkombëtare që mund të ofrojnë sistemin e kërkuar të inspektimit elektronik;
- (vi) Vlerësimin e detajuar të buxhetit.

Detyra 2.4: Dizajni i nivelit të lartë dhe specifikimet funksionale dhe teknike për sistemin e interoperabilitetit të inspektimit dhe përditësimi i infrastrukturës së sistemit,duke marrë parasysh portën hyrëse ekzistuese të interoperabilitetit të ASHI-së dhe kapacitetet e infrastrukturës ekzistuese të sistemit në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Kërkesat e interoperabilitetit do të përfshijnë integrimin e të gjitha regjistrave dhe sistemeve të tjera të informacionit të nevojshme për zbatimin e inspektimeve të bazuara në rrezik. Sistemi i interoperabilitetit të inspektimit duhet të mundësojë që të gjitha të dhënat e jashtme dhe regjistrat të shkëmbehen me e-inspektimin duke ndjekur një kornizë të standardizuar të interoperabilitetit. Përditësimi i infrastrukturës, përfshirë infrastrukturën e hostingut, duhet të mundësojë një operim të thjeshtë të sistemit të interoperabilitetit dhe të e-inspektimit. Në vijim janë rezultatet e arritshme të detyrës 2.4:

- **Rezultati i arritshëm 2.4.1: Specifikimet funksionale dhe teknike për sistemin e interoperabilitetit të inspektimit dhe përditësimet e infrastrukturës së e-qeverisë, përfshirë:**
 - (i) Deklarata e punës, me dizajn të nivelit të lartë, fushëveprim, arkitekturë konceptuale, qasje të zbatimit, pikat kryesore, detyrat, rezultatet e arritshme, rreziqet, supozimet dhe kufizimet;
 - (ii) Zbërthimi i funksionaliteteve me diagramet e rasteve të përdorimit, përshkrimi i funksionaliteteve të detyrueshme dhe opsionale dhe karakteristikave të tjera;
 - (iii) Kërkesat jofunksionale dhe teknike, përfshirë modelin e shpërndarjes, interoperabilitetin dhe kërkesat e tjera;
 - (iv) Plani i zbatimit dhe inputet e tjera teknike për dokumentacionin e tenderit sipas modelit që do të prezantohet nga klienti;
 - (v) Hulumtimet e tregut për identifikimin e kompanive vendore dhe ndërkombëtare që mund të ofrojnë përditësimet e kërkuara të ndërveprimit dhe infrastrukturës;
 - (vi) Vlerësimin e detajuar të buxhetit.

Detyra 2.5: **Specifikimet teknike të harduerit të inspektorit dhe përdoruesit fundor**, në vijim janë rezultatet e arritshme të Detyrës 2.5:

- **Rezultati i arritshëm 2.5.1: Specifikimet teknike të harduerit të inspektorëve dhe përdoruesit fundor për e-inspektimet, varësisht nga dizajni i sistemit të e-inspektimit.**

3. KALENDARI I REZULTATEVE TË ARRITSHME

Tabela e mëposhtme përmbledh rezultatet e arritshme dhe afatet.

Nr.	Faza/Rezultati i arritshëm	Afati kohor
1	Faza I – Kujdesi i duhur dhe vlerësimi i TIK-ut - Rezultati i arritshëm 1.1.1: Plani teknik për menaxhim të projektit/detyrës - Rezultati i arritshëm 1.2.1: Vlerësimi i kapaciteteve teknike për zbatimin e inspektimeve elektronike dhe të sistemit të interoperabilitetit të inspektimit - Rezultati i arritshëm 1.3.1: Hartëzimi dhe analizimi i procesit të inspektimit AS-IS	3 muaj nga data e fillimit të kontratës
2	Faza II – Dizajni i nivelit të lartë dhe zhvillimi i specifikimeve funksionale dhe teknike - Rezultati i arritshëm 2.1.1: Shënimi dhe koncepti i fizibilitetit për zbatimin e sistemit të e-inspektimeve dhe interoperabilitetit të inspektimit - Rezultati i arritshëm 2.2.1: Dizajnimi i proceseve të inspektimit TO-BE, dokumenteve të inspektimit, dhe të dhënave për inspektimet e bazuara në rrezik - Rezultati i arritshëm 2.3.1: Specifikimet funksionale dhe teknike të e-inspektimit dhe inputeve tjera teknike për dokumentacionin e tenderit - Rezultati i arritshëm 2.4.1: Specifikimet funksionale dhe teknike për sistemin e interoperabilitetit të inspektimit dhe përditësimet e infrastrukturës së e-qeverisë - Rezultati i arritshëm 2.5.1: Specifikimet teknike të harduerit të inspektorëve dhe përdoruesit fundor për e-inspektimet	4 muaj pas fillimit të fazës II - miratimi i ligjit të ri për inspektimet dhe emërimi i inspektorit të përgjithshëm

Niveli i përpjekjeve
Niveli maksimal i vlerësuar i angazhimit është 110 ditë pune për kujdesin e duhur dhe vlerësimin e TIK-ut si dhe dizajnin e nivelit të lartë dhe zhvillimin e specifikimeve funksionale dhe teknike.
Firma konsulente ose një sipërmarrje e përbashkët (JV) kryen shërbimet për një periudhë 7 muaj pas nënshkrimit të Kontratës.

4. KRITERET E KUALIFIKIMIT PËR FIRMËN KONSULENTE

4.1 Kriteret e përgjithshme të kualifikimit për firmën konsulente

Firma konsulente e zgjedhur për zbatimin e detyrave të mësipërme duhet të posedojë:

1. Firma konsulente duhet të dëshmojë kapacitetet e saj profesionale dhe përvojën e mëparshme në projekte të ngjashme në fushën e projektimit dhe zbatimit të inspektimeve elektronike. Në këtë drejtim firma konsulente duhet të dëshmojë kapacitetet e saj profesionale dhe përvojën e mëparshme në projekte të ngjashme në fushën e projektimit dhe zbatimit të e-Inspektimeve. Në këtë drejtim, firma konsulente duhet të sigurojë dëshmi/referencë (minimumi të paktën tri letra referuese) që ka përfunduar në mënyrë të suksesshme dhe substanciale detyra të ngjashme me detyrën e propozuar gjatë (pesë) viteve të fundit (d.m.th. 2015, 2016, 2017, 2018 dhe 2019), duke dhënë informatat e mëposhtme: emri i klientit, kontrata, përshkrimi dhe koha e detyrës së përfunduar, etj. Përvoja e mëparshme duhet të përfshijë gjithashtu zhvillimin e planeve të zbatimit të ngjashme me .
2. Firma konsulente duhet të dëshmojë kapacitetet e saj të personelit duke ofruar CV në gjuhën angleze dhe Certifikata të ekspertëve me përvojë në hartimin, krijimin e regjistrave publik, sistemin DMS, nxjerrjen e të dhënave (data mining), shkëmbimin e të dhënave dhe/ose interoperabilitetin e regjistrave të ndryshëm.
3. Standardet ISO 9001 dhe 27001 (dorëzimi i kopjes së certifikatës)
4. Përvoja paraprake e zhvillimit dhe zbatimit të planeve në mënyrë ideale për një shkallë të gjerë të projekteve të TI-së. Kjo duhet të përfshijë zhvillimin e planeve të programit me role dhe përgjegjësi të caktuara, monitorimin e performancës dhe menaxhimin e rreziqeve kryesore me projektet e orientuara nga biznesi të TI/IS;

5. INFORMACIONE TË TJERA

5.1 Raportimi

Gjatë rrjedhës së detyrës, firmës konsulente i kërkohet të paraqesë raportet e mëposhtme:

- Raport mbi progresin e zbatimit, duke përfshirë një përshkrim të analizës së realizuar dhe specifikimeve dhe rreziqeve të perceptuara që mund të ndikojnë në realizimin e detyrës.

5.2 Periudha e ekzekutimit

3 muaj – faza I – Kujdesi i duhur dhe vlerësimi i TIK-ut
4 muaj - faza II – Dizajni i nivelit të lartë dhe zhvillimi i specifikimeve funksionale dhe teknike

5.3 Formati dhe pronësia e rezultateve të arritshme

I gjithë dokumentacioni që duhet të dorëzohet si pjesë e kësaj kontrate duhet të jetë në Microsoft Word ose Excel 2003 ose më të vonshme. Të gjitha rezultatet e arritshme, të ofruara nga firma konsulente në kuadër të këtij projekti, do të jenë pronë e Projektit MTI/CERP.

Të gjitha rezultatet e arritshme do të paraqiten për rishikim dhe pranim në një takim të firmës konsulente para Klientit i cili do të menaxhojë zbatimin e inspektimeve elektronike, që është Projekti MTI/CERP.

5.4 Procesi i përzgjedhjes

Firma konsulente do të përzgjidhet duke u bazuar në:

- Përvojën e firmës në hartimin e inspektimeve elektronike. (40%)
- Përvojën e punëve të tilla në zbatimin e projekteve të ngjashme (40%)
- Disponueshmëria e stafit të kualifikuar brenda organizatës së firmës (20%)

Firma konsulente ose sipërmarrja e përbashkët do të përzgjidhet në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimet e Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve sipas kredive dhe granteve IBRD dhe IDA nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011 dhe rishikimi i korrikut 2014, sipas përzgjedhjes bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat e interesuara të konsulencës apo NP-të mund të marrin informata shtesë në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës: 08:00-16:00 (nga e hëna deri të premten). Shprehja e interesit duhet të dorëzohet në formë të shkruar apo me e-mail, në adresën e mëposhtme deri më 04 Gusht 2020.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Personi kontaktues: Aferdita Selmani
Adresa: Rr. "Muharrem Fejza" p.n. Lagjja e Spitalit
10000 Prishtinë/Republika e Kosovës
Email:aferdita.a.selmani@rks-gov.net